



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA THEMELORE GJILAN**

---

Numri i lëndës: 2018:044096

Datë: 06.09.2018

Numri i dokumentit: 00114942

*P. nr. 714/18*

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjykatëses së vetme gjykuese, Luljete Shabani, në lëndën penale kundër të akuzuarit R.I. nga Gjilani, të cilin, sipas autorizimit e mbron, av. F.Y., për veprën penale, Rrezikimi i trafikut publik, nga neni 378 paragrafi 8 lidhur me par.6 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm PP. II nr. 1230/2018, të datës 22.08.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik, më datën 03.09.2018, mori dhe në prezencë të palëve, shpalli, dhe më datë 06.09.2018 përpiloi këtë:**

**AKT GJYKIM**

*I akuzuari R.I., nga babai B. dhe nëna Xh., e lindur K., i lindur më datë ... në fsh. ..., K. e ..., jeton në Gjilan, në rr. “ ... ” nr. ..., i martuar, baba i një fëmije, i papunë, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës*

**Ë S H T Ë F A J T O R**

*Sepse, më datë 10.08.2018, rreth orës 20.15 min. në Gjilan, në rr. “Abdullah Presheva”, nga pakujdesi, ka rrezikuar trafikun publik, duke vënë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinën e tyre, ashtu që duke drejtuar automjetin e markës “VW Golf”, me tabela të regjistrimit ..., ka vepruar në kundërshtim të dispozitës ligjore të nenit 53.1 të Ligjit për rregullat e trafikut rrugor-sipas së cilës, shoferi duhet t’ua përshtatë shpejtësinë e lëvizjes fushëpamjes në rrugë, gjendjes dhe llojit të rrugës, kushteve teknike dhe atmosferike, ngarkesës së mjetit, dendësisë së trafikut, gjendjes psiko-fizike t tij dhe aftësive personale të tij, ashtu që të jetë në gjendje ta ndalë mjetin para çdo pengese që mund të paraqitet në kushtet e dhëna-brenda kufijve të fushëpamjes, përkatësisht mund të veprojë me kohë dhe duke lëvizur në rrugën “Abdullah Preheva” në drejtim të rrugës Qarkore, me të arritur përballë autolarjes “ ... ”, duke bërë vozitje të pakujdesshme, me pjesën e përparme, me retovizorin e anës së djathtë, e ka goditur në trup të dëmtuarin I.S., i cili ishte duke lëvizur në rrugën “A.Presheva”, në drejtim të qytetit, skajit të djathtë të rrugës të drejtimin të lëvizjes së automjetit, ku si pasojë i dëmtuari ka pësuar lëndime të rënda trupore, për shkak të të cilave ka kërkuar ndihmë mjeksore në Emergjencën e Spitalit Regjional në Gjilan, e më pas është transferuar në QKUK në Prishtinë*

*-me çka ka kryer veprën penale, **Rrezikimi, i Trafikut Publik, nga neni 378 paragrafi 8 lidhur me par. 6 të KPRK-së, andaj, Gjykata, bazuar në dispozitat e neneve 7,17,21,51,73,114,të KPRK-ës, dhe neni 365, 453 dhe 463 të KPRK-së,***

**E GJYKON**

**Të akuzuarin R.I. me Dënim me Burg**, në kohëzgjatje prej **6 (gjashtë) muajve**, ashtu që, në mbështetje të **nenit 47 të KPRK-së**, me pëlqimin e të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij, av. F.Y., dënimi i shqiptuar me burg, **do t'i zëvendësohet në Dënim Gjore**, në shumë prej **2500 (dymijë e pesëqind) €**, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar ta paguajë në afatin prej **15 ditësh** nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.

Në dënimin e përmendur, të akuzuarit R.I. do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak, nga data 11.08.2018, deri më dt. 03.09.2018.

Në bazë të nenit 39 par.4 nënpar. 3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, të akuzuarit shqiptohet taksa në shumën prej **30 (tridhjetë) €**

Obligohet i akuzuari që t'i paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor në lartësi prej **20 (njëzet) €**, te gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur Aktakuzën PP. II nr. 1230/2018, të datës 22.08.2018, kundër të akuzuarit R.I., për veprë penale, Rrezikimi itrafikut publik, nga neni 378 par.8 lidhur me par.6 të KPRK-së dhe ka kërkuar që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet me dënim meritor sipas ligjit.

Gjykata analizoi provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe me vet pranimin e fajsisë nga ana e të akuzuarit erdhi në përfundim se i akuzuari R.I. e ka kryer veprën penale, Rrezikimi i Trafikut Publik, nga neni 378, par. 8 lidhur me par.6 të KPRK-së, kështu që nuk pati nevojë të procedohen prova të tjera..

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, Gjykata pati parasysh rrethanat e parapara me nenin 73 të KPRK-së, dhe si rrethanë lehtësuese gjeti se i akuzuari pati sjellje korrekte në Gjykatë, pranoi fajesine, se është pënduar për veprën në fjalë, ndërsa si rrethanë rënduese, mori parasysh rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale dhe dëmin e shkaktuar nga i pandehuri, me bindje se një dënim i tillë është në përputhshmëri me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe se me të do të arrihet qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 453 të KPRK -së.

Nga të cekurat më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **GJYKATA THEMELORE GJILAN DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

**2018:044096, 06.09.2018**

**Gjykatësja e vetme gjyqësore,  
Luljete Shabani**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë Departamenti i Përgjithshëm, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të së njëjtës, ankesa dorëzohet në dy ekzemplar përmes kësaj Gjykate.